

Zgjedhjet lokale 2021 dhe roli i institucioneve antikorupsion

Zgjedhja e qytetarëve në zgjedhjet lokale do të përcaktojë se kush do të udhëheqë komunitetin lokal dhe në cilin drejtim do të shkojë zhvillimi lokal. Është e qartë se çështjet lokale po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për qytetarët pasi qeverisja në nivel lokal ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre.

Financimi i fushatës për zgjedhjet lokale është indikator kryesor për legjitimitetin e procesit zgjedhor. Si themelues i institucioneve kryesore anti-korrupsion me kompetencat më të gjera në procesin zgjedhor, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe Enti Shtetëror për Revizion (ESHR), Kuvendi ka një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së financimit të fushatës politike.

ESHR, brenda kompetencave të tij, kryen revizion të pasqyrave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet në fushatat zgjedhore. Revizori shtetëror është i detyruar të kryejë revizion, ndërsa nëse vëren parregullsi, paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ose paraqet denoncim tek prokurori publik kompetent. ESHR gjithashtu jep rekomandime në lidhje me Kodin Zgjedhor që është me rëndësi Kuvendi ta shqyrtojë në mënyrë që t'i zbatojë ato në ciklet e ardhshme zgjedhore.

KSHPK ka përgjegjësi të rëndësishme në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore. Njëra prej tyre është monitorimi i ligjshmërisë së financimit të fushatës zgjedhore nga KSHPK. KSHPK -ja, mund të fillojë procedurat për të vërtetuar situatën faktike në rast dyshimi ose kundërshtimi për financim të paligjshëm të fushatës. Për më tepër, KSHPK është kompetente për monitorimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve buxhetore nga dita e shpalljes deri në përfundimin e zgjedhjeve, si dhe për përcaktimin e keqpërdorimit të financimit të partive politike gjatë fushatës zgjedhore. Komisioni është i detyruar të shqyrtojë këto kërkesa dhe të paraqesë raport të veçantë në Kuvend për financimin e fushatës zgjedhore, jo më vonë se tre muaj nga dita e përfundimit të zgjedhjeve. Në mënyrë plotësuese, personave që punojnë për të parandaluar korrupsionin u sigurohet mbrojtje dhe pavarësi e plotë, dhe nëse ushtrohet presion, KSHPK -ja, menjëherë e informon Kuvendin.

Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore dorëzojnë raport financiar total në Kuvend, Komisionit Shtetëror Zgjedhor, ESHR-së, KSHPK-së dhe këshillit komunal dhe këshillit të Qytetit të Shkupit. Bankat ku janë hapur llogaritë e transaksioneve për fushatën janë të detyruara t'i sigurojnë KSHPK-së dhe ESHR-së, qasje elektronike falas në të gjitha ndryshimet e llogarisë.

Institucionet antikorupsion janë të detyruara të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me Komisionin Shtetëror Zgjedhor gjatë fushatës zgjedhore. Në vigjilje të zgjedhjeve të ardhshme lokale, KSHPK së bashku me ESHR-në, formuan një ekip të përbashkët për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të dy institucioneve me qëllim sigurimin e të dhënave nga institucionet dhe llogaritë e transaksioneve të pjesëmarrësve në zgjedhjet lokale. Është e rëndësishme që deputetët të monitorojnë nga afër procesin zgjedhor dhe të rishikojnë dhe diskutojnë me kujdes raportet e përgatitura nga KSHPK dhe ESHR, me qëllim rritjen e llogaridhënies së partive politike, përmirësimin e kuadrit ligjor për zgjedhjet dhe përfundimisht rritjen e besimit në procesin zgjedhor.

Projekti "Biseda anti -korrupsion në Kuvend (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) përfshin aktivitete kërkimore dhe përfaqësuese me qëllim kryesor, mbështetjen e procesit reformues në Maqedoninë e Veriut, përmes forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti mbështetet nga Fondi Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen është përgjegjës IDSCS dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Fondit Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy- NED).